



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 449 / 23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 19. 04. 2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragr. 14 dhe 44 paragr. 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për organizim të manifestimit që do të mbahet me datën 30 qershor 2023 në fshatin Vesekoc.
2. Në përbërje të Këshillit Organizativ caktohen:
 - 2.1 z. Burim Rexhepi, Kryesues i Këshillit Organizativ
 - 2.2 z. Mentor Hasani, anëtar
 - 2.3 z. Dorajet Imeri, anëtar
 - 2.4 z. Gazmend Boletini
 - 2.5 z. Hajzer Istrefi, anëtar
3. Këshilli organizativ në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis ftesat dhe dërgoj për pjesëmarrje në këtë manifestim në kuadër të të cilit do të mbahet poashtu simpozium shkencor. KO gjithashtu do të ndërmerr të gjitha masat tjera rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së këtij manifestimi.
4. Kryesuesi i KO në koordinim me Drejtoreshën e DKRS do të informojnë me kohë Kryetarin e Komunës lidhur me përgatitjet për këtë manifestim.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për KRS
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 6 të Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe nenin 50 të Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Vushtrrisë 01Nr. 67/15, datë 26.03.2015, Kryetari i Komunës jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

1. Ndalohet qarkullimi i mjeteve motorike të transportit të mallrave me peshë mbi 3.5 ton në qytet, në rrugët:
 - 1.1 „Vesli Klark”
 - 1.2 „Hasan Prishtina”
 - 1.3 „Isa Boletini”
 - 1.4 „Ruzhdi Hyseni”
 - 1.5 „Bislim Bajgora”
 - 1.6 „Basri Beqiri”
2. Ndalim qarkullimi sipas pikës paraprake të kësaj urdhërese vlen për ditët: e hënë – e shtunë, prej orës 10:00 deri 23:00
3. Drejtoria për Shërbime Publike obligohet që në afat sa më të shkurtër kohorë të vendosë shenjat e sinjalizimit vertikal të ndalim qarkullimit për rrugët e specifikuar dhe kohën e ndalim qarkullimit, të përcaktuar në pikën 1 (një) dhe 2 (dy) të kësaj urdhërese.
4. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe do të filloj të zbatohet menjëherë.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Urdhëresa iu dërgohet:

- Drejtorisë për Shërbime Publike
- Zyrës për Informim
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	484 / 23
Nr. i sq. / Br. st	-02-
Data: / Datum	25.04.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës si dhe nenin 19 paragr. 1 të Rregullores (KKV) Nr. 08/2020, prot. 01nr.209/20, dt.29.10.2020 për Dhënien e Dekoratave, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR DEKORATA

1. Formohet komisioni për propozim të ndarjes së dekoratave me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2023 në këtë përbërje:
 - 1.1 **znj. Medina Bunjaku**, kryesuese e komisionit
 - 1.2 **z. Ergin Sunguri**, anëtar
 - 1.3 **z. Benjamin Shala**, anëtar
 - 1.4 **z. Shaip Hyseni**, anëtar
 - 1.5 **z. Ujmir Uka**, anëtar
2. Propozimet për dekorata për nderë të Ditës së Çlirimit bëhen kryesisht për ndarje të Mirënjohjeve, mirëpo mund të bëhen edhe për dekorata tjera.
3. Komisioni gjatë punës së tij duhet bazohet në Rregulloren komunale në fuqi për Dhënien e Dekoratave. Këto propozime përfshijnë fushat si: ekonomi, arsim, shëndetësi, kulturë rini sport, administratën komunale si dhe fusha tjera, për kontribute të veçanta.
4. Komisioni do të shqyrtoj të gjitha iniciativat gjegjësisht propozimet për ndarje të dekoratave të cilat duhet të jenë të arsyetuara me shkrim. Në rast se ju mungon arsyetimi kryesuesja e komisionit do të ia kthej propozuesit për të dhënë arsyetimin me shkrim.
5. Komisioni bënë përzgjedhjen paraprake dhe i propozon listën e ngushtë Kuvendit të Komunës për miratim. Në këtë rast, kryesuesja e komisionit e arsyeton para anëtarëve të kuvendit listën e propozimeve.
6. Para përcaktimit të propozimeve për dekorata, komisioni do të verifikoj nga lista e dekoratave nëse ndonjëri nga të propozuarit iu është nda dekoratë në vitet paraprake. Në rast se në listë figuron emri i ndonjërit i cili ka marrë më herët dekoratë, ai nuk mund të propozohet për dekoratë të njejtë apo dekoratë më të ultë. Lista e dekoratave të ndara më herët bashkëngjitet në shtojcë të këtij vendimi.

7. Komisioni do të filloj me punë menjëherë në mënyrë që propozimet të përgatiten me kohë për mbledhjen e kuvendit të komunës e cila do të mbahet në fund të muajit maj 2023.
8. Komisioni përveç propozimeve për Ditën e Çlirimit në qershor të këtij viti, ka mandat edhe për raste tjera të dhënies së propozimeve për dekorata, brenda vitit 2023.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 485 / 23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 25.04.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragraf. 14 dhe 44 paragraf. 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZATIV

1. Formohet Këshilli Organizativ për shënimin e 60 vjetorit të fillimit të punës së Gjimnazit në Vushtri.
2. Në përbërje të Këshillit Organizativ caktohen:
 - 2.1 z. Enver Bajrami, Kryesues i Këshillit Organizativ
 - 2.2 z. Gëzim Saqraqi, anëtar
 - 2.3 z. Murteza Dallku, anëtar
 - 2.4 z. Lulzim Bivolaku, anëtar
3. Këshilli Organizativ do të vendos për kohën dhe vendin e mbajtjes së këtij manifestimi.
4. Këshilli organizativ do të përgatis ftesat për pjesëmarrje në këtë manifestim dhe ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet tjera të nevojshme rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së këtij manifestimi.
5. Kryesuesi i KO në koordinim me Drejtorin e Drejtorisë për Arsim do të informojnë me kohë Kryetarin e Komunës lidhur me përgatitjet e shënimit të këtij përvjetori.
6. Këshilli Organizativ duhet të filloj me punë menjëherë.
7. Mandati i këshillit do të zgjas deri në përfundimin e shënimit të këtij manifestimi.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Anëtarëve të Këshillit Organizativ
- Arkivit të Sekretarisë.